# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6190
E hënë, 14 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €


## Gjermania mbyll shkollat dhe dyqanet

FAQE 2





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MAZLLUM BARALIU

# ËSHTË MOMENTI I FUNDIT QË KLASA POLITIKE TË REFLEKTOJË

FAQE 4-5



Njohësi i çështjeve juridike dhe kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka thënë se në afatet kushtetuese që jemi nuk mund të zgjedhet një president drejtpërdrejt nga qytetarët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë drejtim do të jetë pengesë bllokada që është krijuar me Kushtetutën e Ahtisarit ku, pos 2/3-tave, kërkohet edhe shumica e deputetëve pakicë e, sipas tij, ndryshimet kushtetuese hëpërhë janë të pamundshme. Ai ka thënë se zgjidhja e vetme është që partitë në pushtet dhe ato në opozitë të merren vesh për një president konsensual, pastaj të shkohet në zgjedhje të reja. "Ose varianti tjetër, nëse nuk merren vesh vetëm për pakon e presidentit, atëherë të merren vesh për të dyja pakot: zgjedhjen e presidentit dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të reja", ka thënë Baraliu, duke shtuar se zgjedhjet e reja do të duhej të mbaheshin në muajin mars ose prill të vitit të ardhshëm

## KOSOVA PRITET TË MARRË VAKSINA KUNDËR COVIDIT PËR 20 PËR QIND TË POPULLATËS

FAQE 3




Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije të dielën se institucionet e vendit janë duke u përgatitur për vendosjen e masave të nevojshme për ta parandalur përhapjen e Covid-19 gjatë festave të fundvitit. Po ashtu, ai ka treguar se Kosova është pjesë e koalicionit COVAX dhe pret ta marrë vaksinën për 20 për qind të popullsisë



## POLICIA KAP MBI 50 KILOGRAMË DROGË NË PRISHTINË

## OPINION

### BEOGRADI, KRYEQYTET I TERRORIZMIT
F. 11

Shkruan: Ragip SHALA



### DRITËHIJET E EKONOMISË SË KOSOVËS
F. 6

Nga Mehmet PRISHTINA



## AKTUALE

### INAUGUROHET SHTËPIA E TË MOSHUARVE "JETIMAT E BALLKANIT" NË SUHAREKË
F. 7

### DEPONOHEN KËRKESAT PËR PAGESËN E AVOKATËVE TË SPECIALES
F. 5



## EKONOMI

### A PO E KRYEJNË BANKAT DETYRËN E TYRE GJATË PANDEMISË?
F. 8

### AZEMI: PUNËTORËT E SEKTORIT PRIVAT NGA MOSPAGESA E TRUSTIT BRENDA NJË VITI HUMBIN 50 MILIONË EURO
F. 8

## SPORT

### PRISHTINA MPOSHTI BALLKANIN NË DERBI
F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Gjermania mbyll shkollat dhe dyqanet

Berlin, 13 dhjetor - Gjermania ka vendosur t'i mbyllë shkollat, dyqanet që shesin mallra jo-thelbësore dhe sallonet e bukurisë. Njoftimi u bë me dije nga kancelarja gjermane, Angela Merkel, e cila tha se masa ndërmerret për të ndaluar një "rritje eksponenciale" të përhapjes së Covid-19 në ekonominë më të madhe të Evropës. "Ekziston një nevojë urgjente për të marrë masa", ka thënë Merkel.

Masat e reja do të vlejnë deri më 10 janar. Vetëm bizneset thelbësore të shitjes me pakicë, të tilla si supermarketet dhe barnatoret, si dhe bankat, do të qëndrojnë të hapura. Kompanive u është kërkuar që punonjësve t'u kërkohet të punojnë nga shtëpia. Gjermania ka qenë në një bllokim të pjesshëm për gjashtë javë, por dyqanet dhe shkollat kanë qenë të hapura. Disa rajone tashmë kanë vendosur masa më të ashpra. Të dielën në Gjermani u raportuan edhe 20 200 raste të reja me koronavirus duke e çuar numrin e përgjithshëm të të infektuarve në 1 320 716. Autoritetet shëndetësore njoftuan edhe për 321 viktima. Deri më tani në Gjermani nga sëmundja Covid-19 kanë vdekur 21 787 persona.



# OKB-ja: Bota duhet të shpallë emergjencë klimatike

**Nju-Jork, 13 dhjetor** - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, i bëri thirrje çdo vendi në botë që të deklarojë një "gjendje të emergjencës klimatike". Ai komentet i bëri gjatë një samiti online për ta shënuar përvjetorin e pestë të marrëveshjes së Parisit për klimën. Gutteres i tha Samitit se një emergjencë globale duhet të mbetet në fuqi derisa të arrihet neutraliteti i karbonit dhe të mos lëshohen më gazra serë në atmosferë. Udhëheqës nga më shumë se 70 vende - por jo Shtetet e Bashkuara, morën pjesë në ngjarje dhe diskutuan planet ambicioze për ta luftuar ngrohjen globale. Kancelarja gjermane Angela Merkel premtoi më shumë se 600 milionë dollarë për t'i mbështetur përpjekjet globale për ta luftuar ndryshimin e klimës, duke thënë se "të gjitha shtetet duhet të jenë në gjendje t'i financojnë investimet e nevojshme për mbrojtjen e klimës". Presidenti kinez Xi Jinping tha se vendi i tij do t'i ulte emetimet me 65 për qind para vitit 2030 krahasuar me nivelet e vitit 2005.




Marrëveshja e Parisit, që u nënshkrua më 2015, i detyroi pjesëmarrësit të ndërmarrin hapa në përpjekje për ta kufizuar ngritjen e temperaturës globale në më pak se 2 gradë Celsius. Sidoqoftë, Kombet e Bashkuara kanë paralajmëruar që temperatura e Tokës pritet të rritet më shumë se 3 gradë këtë shekull. Shtetet e Bashkuara, të cilat lëshojnë rreth 15 për qind të gazrave serë, u bënë vendi i parë që la marrëveshjen. Administrata e presidentit në largim të ShBA-së, Donald Trump, u tërhoq në nëntor. Masa erdhi tre vjet pasi Trump njoftoi planet e tij për ta lënë marrëveshjen. Presidenti i zgjedhur, Joe Biden, më 12 dhjetor tha se Shtetet e Bashkuara do të jenë sërish pjesë e marrëveshjes. "Unë menjëherë do të filloj të punoj me homologët e mi në të gjithë botën për të bërë gjithçka që mundemi, duke përfshirë edhe thirrjen e liderëve të ekonomive kryesore për një samit të klimës brenda 100 ditëve të para në detyrë", ka thënë Biden.

Në vërejtjet e tij në samit, Guterres e quajti zotimin e Bidenit për t'u kthyer në marrëveshjen e Parisit "një sinjal shumë i rëndësishëm". "Ne shpresojmë tani e tutje për një udhëheqje shumë aktive të ShBA-së në veprimet klimatike", ka thënë Guterres.

# Mbi 72 milionë raste me Covid-19 në mbarë botën

**Nju-Jork, 13 dhjetor** - Numri i rasteve me Covid-19 në mbarë botën ka shkuar në mbi 72 milionë. Sipas faqes së internetit "Worldometer", e cila përpilon të dhënat në lidhje me pandeminë, deri më tani në mbarë botën janë regjistruar 72.014.399 raste me Covid-19 i cili për herë të parë u shfaq në Wuhan të Kinës dhe më pas u përhap në të gjithë botën. Numri më i madh i rasteve është regjistruar në ShBA, me gjithsej 16.496.348 raste deri më tani, e cila pasohet nga India (9.854.208), Brazili (6.880.127), Rusia (2.625.848), Franca (2.365.319), Britania e Madhe (1.830.956), Italia (1.825.775), Turqia (1.809.809), Spanja (1.741.439), Argjentina (1.489.328), Kolumbia (1.408.909), Gjermania (1.320.592), Meksika (1.229.379), Polonia (1.126.700) dhe Irani (1.100.818). Për shkak të Covid-19 deri më tani në mbarë botën kanë humbur jetën 1.610.067 persona ndërsa 50.411.543 janë shëruar duke mposhtur virusin.



## Izraeli dhe Butani vendosin marrëdhënie diplomatike



**Jerusalemi, 13 dhjetor** - Izraeli ka vendosur marrëdhënie diplomatike me mbretërinë e Butanit, kanë bërë me dije zyrtarë të Ministrisë së Jashtme e Izraelit. "Rrethi i njohjes së Izraelit po zgjerohet. Vendosja e marrëdhënieve me Mbretërinë e Butanit do të përbëjë një fazë të re në thellimin e marrëdhënieve të Izraelit në Azi", ka thënë ministri i Jashtëm i Izraelit, Gabi Ashkenazi në një deklaratë.

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu e përshëndeti marrëveshjen, duke thënë se Izraeli ishte "në kontakt edhe me vendet e tjera që duan të krijojnë marrëdhënie me shtetin hebre". Marrëveshja me Butanin vjen disa ditë pasi Maroku pranoi të normalizojë marrëdhëniet me Izraelin, shteti i katërt arab që e bën këtë që nga muaji gushti. Sipas disa analistëve, normalizimi i raporteve me Izraelin mund të përfshijë edhe disa vende tjera, përfshirë Arabinë Saudite, Omanin dhe disa vende aziatike që kundërshtojnë tradicionalisht Izraelin, të tilla si Indonezia.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kosova pritet të marrë vaksina kundër Covidit për 20 për qind të popullatës

Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije të dielën se institucionet e vendit janë duke u përgatitur për vendosjen e masave të nevojshme për ta parandaluar përhapjen e Covid-19 gjatë festave të fundvitit. Po ashtu, ai ka treguar se Kosova është pjesë e koalicionit COVAX dhe pret ta marrë vaksinën për 20 për qind të popullsisë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se institucionet e vendit janë duke u përgatitur për vendosjen e masave të nevojshme për ta parandaluar përhapjen e Covid-19 gjatë festave të fundvitit. "Institucionet shëndetësore do të mbesim të mobilizuara. Po përgatisim skenarët për masat e nevojshme për festat e fundvitit kur ka frekuentim më të madh të qytetarëve, përfshirë edhe ardhjen e bashkatdhetarëve", ka thënë kryeministri Hoti përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ku ai ka treguar për situatën e pandemisë në Kosovë.

Sipas kryeministrit Hoti, institucionet po punojnë shumë për sigurimin e vaksinës kundër koronavirusit. "Jemi pjesë e koalicionit COVAX dhe presim të marrim vaksina për 20 për qind të popullsisë. Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë është në kontakt me kompaninë prodhuese të vaksinës, si dhe po punojmë me vendet partnere për të kërkuar mbështetje direkte nga to", ka deklaruar Hoti.

Vaksinat kërkojnë kushte të veçanta të transportit dhe ruajtjes.

Shembull vaksina e kompanisë "Pfizer"-it, e cila është miratuar për përdorim në Mbretërinë e Bashkuar, ShBA dhe në disa vende të tjera, kërkon kushte të mbajtjes në temperaturë -70 gradë celsius. Kryeministri Hoti ka thënë se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike po punon për sigurimin e pajisjeve të nevojshme teknike për ruajtjen dhe shpërndarjen e vaksinës në të gjitha komunat. "Instituti ka bërë gati planin e vaksinimit, duke vendosur me prioritet të moshuarit dhe qytetarët me sëmundje kronike, krahas punëtorëve shëndetësorë të cilët janë në ballë të kësaj beteje", ka deklaruar kryeministri Hoti.

### Dymbëdhjetë të vdekur dhe 462 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) janë testuar gjithsej 1 314 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 462 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 12 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë dy raste (80, 72 vjeç), Malishevë dy raste (78, 60 vjeç), Prizren një rast ( 79 vjeç), Mitrovicë një rast ( 69 vjeç), Pejë një rast (83 vjeç), Vushtrri një rast (80 vjeç), Kamenicë një rast (74 vjeç), Gjakovë një rast (85 vjeç), Podujevë një rast ( 51 vjeç), Istog një rast ( 82 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 46 580 raste nga 163 221 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 198 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 536 pacientë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 33 600 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 782.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 175 raste, Mitrovicë 55 raste, Fushë-Kosovë 30 raste, Podujevë 27 raste, Ferizaj 22 raste, Lipjan 21 raste, Vushtrri 16, Prizren 14 raste, raste, Gjilan 11 raste, Suharekë 11 raste, Drenas 9 raste, Kamenicë 9 raste, Viti 9 raste, Obiliq 8 raste, Skenderaj 8 raste, Gjakovë 6 raste, Pejë 6 raste, Istog 5 raste, Kaçanik 4 raste, Deçan 3 raste, Graçanicë 2 raste, Klinë 2 raste, Malishevë 2 raste, Rahovec 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Dragash, Hani i Elezit dhe Kllokot.




## Deputetit Shkëmb Manaj ia shpërthejnë gomat e veturës



PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Shkëmb Manaj, ka njoftuar se dikush ka shpërthyer gomat e veturës së tij në garazhin e objektit ku banon. Manaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se rastin e ka lajmëruar në Policinë e Kosovës dhe ka kërkuar që të zbardhet në tërësi. Deputeti këtë ndodhi e ka lidhur me aktivitetin e tij si politikan dhe shkruan se nuk mund askush ta ndalojë në përfaqësimin e qytetarëve. "Unë asnjëherë në jetën time nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë problem personal me askënd. Prandaj, nëse ky veprim i ulët është tentim që unë të ndalem nga puna ime e përfaqësimit të qytetarëve në Kuvend të Republikës dhe nga angazhimi i çdoditshëm për fuqizimin e shtetit ligjor dhe të së drejtës, e kanë gabim, sepse nuk ka forcë që më ndal nga ky përkushtim", ka shkruar Manaj.



FLET PËR "EPOKËN E RE", MAZLLUM BARALIU

# ËSHTË MOMENTI I FUNDIT QË KLASA POLITIKE TË REFLEKTOJË

Njohësi i çështjeve juridike dhe kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka thënë se në afatet kushtetuese që jemi nuk mund të zgjedhet një president drejtpërdrejt nga qytetarët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë drejtim do të jetë pengesë bllokada që është krijuar me Kushtetutën e Ahtisarit ku, pos 2/3-tave, kërkohet edhe shumica e deputetëve pakicë dhe, sipas tij, ndryshimet kushtetuese hëpërhë janë të pamundshme. Ai ka thënë se zgjidhja e vetme është që partitë në pushtet dhe ato në opozitë të merren vesh për një president konsensual, pastaj të shkohet në zgjedhje të reja. "Ose varianti tjetër, nëse nuk merren vesh vetëm për pakon e presidentit, atëherë të merren vesh për të dyja pakot: zgjedhjen e presidentit dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të reja", ka thënë Baraliu, duke shtuar se zgjedhjet e reja do të duhej të mbaheshin në muajin mars ose prill të vitit të ardhshëm

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 DHJETOR -

**"Epoka e re"**: *Z. Baraliu, si njohës i çështjeve juridike dhe kushtetuese, duke e parë situatën çfarë po ndodh me çështjen e zgjidhjes së presidentit të vendit, a mendoni se është koha që këtë herë presidenti të zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët?*

**Baraliu:** Në afatet kushtetuese që jemi, ku në ushtrim të detyrës së presidentit është kryetarja e Kuvendit të Kosovës, afati është shumë i ngushtë dhe po ngushtohet gjithnjë e më tepër. Pra, po flas në këtë gjashtëmujorin maksimal që të kemi mundësi dhe hapësirë për ndryshimet kushtetuese. Është e domosdoshme që të kemi një harmonizim të qëndrimeve të kësaj klase politike, të partive në pushtet dhe atyre në opozitë, sepse kohë nuk kemi shumë. Edhe po të kishim kohë, ne e kemi sjell vendin në atë gjendje që jemi të bllokuar me Kushtetutën e Ahtisarit, e cila pothuajse është e pamundur për të krijuar zgjidhje.

**"Epoka e re"**: *Pse?*

**Baraliu:** Duhet shumica e deputetëve, 2/3-tat, dhe shumica e deputetëve pakicë. Pra, shumica e ashtuquajtur e Badinterit. Për këtë punë Lista Serbe, por edhe komunitetet pakicë për çështjet që atyre u interesojnë mund ta pranojnë një zgjidhje, por për interesat e shtetit dhe popullsisë që janë në interesin tonë, në këtë rast zgjedhja e presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk u intereson, atëherë nuk mund të kemi ndryshim. Jemi në një situatë të pamundësisë për ndonjë zgjidhje tjetër. Zgjidhja e vetme është që partitë politike dhe koalicioni qeverisës duhet të merren vesh për një president konsensual dhe pastaj të shkohet në zgjedhje të reja. Ose varianti tjetër, nëse nuk merren vesh vetëm për pakon e presidentit, atëherë të merren vesh për të dyja pakot: zgjedhjen e presidentit dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Në këtë variant të fundit do të pajtoheshin të gjitha partitë kur në marrëveshje hyn edhe çështja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat do të duhej të mbaheshin në një afat optimal, në muajin mars ose prill të vitit të ardhshëm.

**"Epoka e re"**: *Ju a jeni ithtar që presidenti të zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët?*

**Baraliu:** Unë dhe çdokush tjetër do të duhej të ishte pro zgjedhjes së presidentit nga qytetarët, sepse demokracia e drejtpërdrejtë është demokraci reale. Demokracia indirekte është demokraci përfaqësuese. Keni parasysh se çfarë bëhet me deputetët ku, sipas këtij sistemi zgjedhor që kemi, marrin besimin të zgjedhësit e tyre, elektorati, dhe një herë në katër vjet shihet me të. Pra, formula që është tani për zgjedhjen e presidentit ka sjellje dhe mundësi për tregti politike dhe në këtë drejtim krijon edhe vështirësi të mëdha. Prej kohës së presidentit të parë që u zgjodh Ibrahim Rugova kishte vështirësi të mëdha në zgjedhjen e tij. Dhe vazhdojmë të kemi vështirësi të mëdha në këtë pikë. Gjithashtu kemi probleme me Kushtetutën dhe Gjykatën Kushtetuese, e cila ka rrëzuar dy presidentë për shkak se partitë politike bëjnë pazare edhe me presidentin. Bëhen kombinime politike duke mos lejuar që drejtpërdrejt të kemi një president të zgjedhur nga qytetarët, i cili pastaj do të kishte edhe kredibilitet më të madh dhe pavarësi më tepër të



veprimit. Në këtë drejtim nuk do të kishim situata kur presidenti bën pazarllëqe për të krijuar ose rrëzuar qeveri.

**"Epoka e re":** *A besoni se do të ketë pajtim mes partive politike në pushtet në opozitë për të gjetur një formulë për zgjedhjen e presidentit të ri?*

**Baraliu:** Fatkeqësisht, duke e parë klimën politike të veprimit, kalkulimeve dhe të ambicieve politike që ndonjëherë janë të pazakonshme dhe të paarsyeshme, sepse njerëzit të imponohen duke mos u bazuar apo vrarë mendjen në fuqinë politike që kanë dhe vullnetin e qytetarëve që kanë marrë, qytetarët me këtë klasë politike që 20 vjet janë lodhur dhe zhgënjyer. Këtë lodhje dhe zhgënjim të qytetarëve nuk po e sheh si duket kjo klasë politike. Po shihet një përpjekje e tyre më shumë për pushtet dhe jo për avancim të shtetit. Këto parti politike, secila në mënyrën e vet, me përjashtime të vogla ose fare, po dëshmojnë se nuk e kanë angazhimin e tyre politik për shtetin dhe qytetarët, por për interesat e tyre të ngushta partiake dhe për kalkulimet e tyre. Kjo klasë politike që 20 vjet ka zhvlerësuar çdo gjë, madje edhe shtetin, duke pranuar fusnota dhe biseda të dëmshme për shtetin. E ka dëmtuar kauzën shtetërore dhe kombëtare. Prandaj, është momenti i fundit që të reflektohet.

# Deponohen kërkesat për pagesën e avokatëve të Speciales

Prishtinë, 13 dhjetor - Ministria e Drejtësisë e Qeverisë e Kosovës deri më tani ka pranuar disa kërkesa nga avokatët për pagesën e tyre lidhur me mbrojtjen e të akuzuarve pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. Në këtë ministri deklaruan për "Radion Evropa e Lirë" se të njëjtat janë në fazën fillestare të shqyrtimit nga komisioni i ministrisë, i cili do të vendosë mbi bazën e parimeve dhe kritereve të cekura me ligj dhe udhëzimet përkatëse.

Institucionet e Kosovës tashmë kanë bërë me dije se aktualisht janë rreth shtatë milionë euro të ndara për vitin e ardhshëm për të akuzuarit në Hagë, kurse trembëdhjetë milionë euro të tjera janë rezervë.

Të akuzuar në Hagë aktualisht janë ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe ish-krerët e UÇK-së, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, Salih Mustafa. Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të gjithë të akuzuarit tashmë kanë ekipet mbrojtëse të përbërë nga avokatë vendorë dhe ndërkombëtarë. Sipas ministrisë, materialet që ndërlidhen me Dhomat e Specializuara janë të klasifikuara me vendimin e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, të nivelit 'sekret', kurse sa iu përket aspekteve financiare, "në një fazë të mëvonshme" ministria do të japë informacion shtesë për opinionin, duke i bërë publike shpenzimet javore të ministrisë, ku do të përfshihen edhe shpenzimet që ndërlidhen me këtë proces.

Ministria aktuale e Drejtësisë, megjithatë, nuk ka dhënë informacione të tjera lidhur me atë se si do të bëhet vlerësimi dhe pagesa e punës së avokatëve.

Sipas një udhëzimi nga 16 nëntori 2020, ministria do ta ketë diskrecionin që të negociojë një marrëveshje për pagesë mujore fikse me mbrojtësin e autorizuar. Në të njëjtin udhëzim është paraparë modelmarrëveshje, që parasheh se "çdo komunikim në të ardhmen në mes të avokatëve dhe klientit, ose në mes të avokatëve dhe ministrisë, është rreptësisht konfidencial".

Por, Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thekson se ligji i aplikueshëm në Kosovë nuk lejon që pagesat për avokatë të jenë sekrete. "Përkundrazi, duhet të jenë transparente dhe të sigurohet që të gjithë të akuzuarit trajtohen drejt, në mënyrë të barabartë", thotë ai. Ai shton se "një qasje e tillë cenon rëndë parimet e transparencës, llogaridhënies dhe mundësisë për të trajtuar në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe sipas kushteve të njëjta të gjithë personat e akuzuar".

Avokati Valon Hasani, i cili është avokat mbështetës i avokates Venkateswari Alagendra, e cila e mbron Jakup Krasniqin, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, nuk ka dashur të flasë nëse ka bërë ndonjë kërkesë për çështje pagese në Ministrinë e Drejtësisë. "Nuk mund t'ju them asgjë. Nuk jam avokati kryesor në rast", ka thënë Hasani.

Ndryshe ish-qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj ka marrë vendim në janar të vitit 2019 që "informacionet që ndërlidhen me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar janë të nivelit 'sekret' dhe mbrohen nga qasja e personave të paautorizuar. Sipas vendimit, përjashtim janë informatat që kanë të bëjnë me mjetet e shpenzuara financiare përkitazi me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare që ndërlidhet me Dhomat e Specializuara".

Në arsyetimin e qeverisë ceket se "është vlerësuar se hapja e paautorizuar e informacioneve të tilla do t'i dëmtonte seriozisht interesat e sigurisë së Kosovës, si dhe informacionet e tilla kanë të bëjnë, ndër të tjera, edhe me marrëshëniet me jashtë të Republikës së Kosovës".

Sipas ligjit, çdo i akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara ka të drejtën për ndihmë financiare dhe mbulim të shpenzimeve të mbrojtjes.

Kurse me udhëzimin administrativ MD - Nr. 02/2020, të datës 24 korrik 2020, të nënshkruar nga ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, përcaktohet se mbulimi financiar i avokatëve bëhet në bazë të tarifave të përcaktuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës; tarifave për avokatë në Holandë; tarifave të shtetit prej nga vjen mbrojtësi dhe tarifave për mbrojtje juridike të personit të akuzuar potencial të Dhomave të Specializuara.

Lidhur me këtë çështje, nga zyra e kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, thanë për "Radion Evropa e Lirë" se "do t'i zbatojnë në përpikëri dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen financiare për mbrojtjen e të akuzuarve nga Dhomat e Specializuara".

Nga ana tjetër, disa qytetarë nga Prishtina me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë kryesisht janë kundër asaj që me para të shtetit të paguhen avokatët e të akuzuarve për krime lufte në Kosovë, por insistojnë edhe për transparencë.

Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera ndaj pakicave etnike dhe rivalëve politikë, të cilat përmenden në Raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty.

Kroacia ka pasur një rast në Hagë - rasti i gjeneralit kroat Ante Gotovina e të tjerëve lidhur me procesin gjyqësor "Stuhia", për të cilin u shpenzuan rreth 28 milionë euro për mbrojtjen. Qeveria kroate nuk ka dashur të tregojë se sa para ka marrë secili nga avokatët.

Vetë avokatët kroatë patën deklaruar në atë kohë se kur ata ishin në Hagë janë paguar 20 000 euro në muaj dhe kur ishin në Kroaci merrnin 10 000 euro. Gjithashtu, qeveria u paguan atyre shpenzimet e udhëtimit dhe hotelit, por jo mëditjet. Vetë Gotovina ka pasur disa avokatë, për të cilët shteti ka paguar së paku rreth 10 milionë euro.



# DRITËHIJET E EKONOMISË SË KOSOVËS

Problemet e grumbulluara në fushën ekonomike nuk mund të tejkalohen brenda natës. Ato kërkojnë qasje serioze dhe një përkushtim më të gjithanshëm jo vetëm të institucioneve shtetërore, por të mbarë shoqërisë, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë. Kjo e fundit duhet të jetë filtri më i besueshëm ku do të ndahej llumi që vjen prej ryshfetxhinjve të lidhur me pushtetin dhe afarizmit të ndershëm, i cili bën të pamundurën që me punë dhe sakrifica të mëdha të ndikojë në mëkëmbjen ekonomike dhe sociale të Kosovës



Nga Mehmet PRISHTINA

Ekonomia e Kosovës i ka dritëhijet e veta dhe, për rrjedhojë, ajo i ka dy narrativa. Në njërën anë e kemi narrativën e afaristëve të suksesshëm, të cilët, pas shumë pengesave, arrijnë ta strukturojnë biznesin e tyre në suaza të një ecurie që ata arrijnë ta mbajnë nën kontroll dhe, në anën tjetër, e kemi narrativën shtetërore, e cila nuk po arrin ta sigurojë dhe mbrojë zhvillimin ekonomik nga informaliteti, nepotizmi dhe nga përpjekjet abuzive të njerëzve të veshur me pushtet, të cilët, në emër të institucioneve që përfaqësojnë, kërkojnë ryshfete për ndërmjetësim dhe në këtë mënyrë i dëbojnë investitorët e huaj.

## Shqetësimet e investitorëve të huaj dhe padrejtësitë ndaj afaristëve vendorë

Po të zhvilloni një anketë me investitorët e huaj do të hasni në disa shqetësime që ata i kanë pasur, siç mund të jenë: mungesa e mbështetjes institucionale dhe lehtësirave për investime të huaja, procedurat e stërzgjatura burokratike për realizimin e investimeve të huaja, problemet në sektorin e energjisë elektrike, mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar, mungesa e sigurisë juridike, mosfunksionimi i sistemit gjyqësor - procedurat e stërzgjatura të kontesteve gjyqësore dhe mungesa e sundimit të shtetit ligjor dhe korrupsioni.

Ditët e fundit në media u raportua se një pronar i një kompanie prodhuese në Kosovë ka hequr dorë nga pjesëmarrja në ofertat e tenderimit publik pasi, siç thotë ai, aty mund të fitojnë "vetëm kompanitë të cilat pranojnë të japin ryshfet". Ai thotë se ka konkurruar disa herë për tender publik, porse nuk ka arritur të përzgjidhet dhe në fund ka hequr dorë pasi, sipas tij, është e kotë: nuk mund të shtyhesh me kompani të cilat japin ryshfet dhe e korruptojnë institucionin.

Që të jetë edhe më tragjike situata, ka pasur raste kur një kompani ka fituar një tender, por e ka rrëzuar Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), duke thyer ligjet dhe duke nxjerrë vendime sipas favoreve.

Sikundër dihet, OShP-ja është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin e prokurimit publik. Brenda vitit janë rreth 700 milionë euro të buxhetit të Kosovës të cilat shpenzohen përmes prokurimit publik.

Mirëpo, siç ankohen afaristët e ndryshëm, korrupsionin e hasin në baza ditore në gati të gjitha institucionet e shtetit, ku ata duhet të kryejnë punë. Ka jo pak kompani të cilat kanë pasur rastin të përballen me korrupsionin si në gjykata, prokurori, ku zakonisht aty ka shumë lëndë që janë lënë të pauzuara, por krejt kjo ka ndodhur me ndikimin e kompanive të tjera, të cilat ndikojnë në vendimet përfundimtare të gjykatave, ku zakonisht dalin fituese ato që janë të lidhura me segmente të caktuara

Afaristët dhe prodhuesit e ndryshëm ankohen gjithashtu edhe për praninë e korrupsionit nëpër komuna, ku ka jo pak raste kur zyrtarë të inspektoratit komunal kërkojnë favore për të kryer punë që me ligj janë të obliguar t'i kryejnë pa pasur nevojë për të dhënë ryshfet.

## Kush po e stimulon biznesin informal?

Dukuria e korrupsionit, që është theksuar edhe në disa raporte ndërkombëtare, e ka vështirësuar në masë të madhe të bërit biznes në Kosovë. Krijimi i një konkurrence të pabarabartë në treg e ka dëmtuar biznesin formal. Për pasojë, ndodhë që një kompani joformale, e cila iu ikën obligimeve shtetërore duke dhënë ryshfet, në një tender publik është në pozitë më të mirë, pasi që do të dalë me një çmim më të lirë krahasuar me bizneset të cilat punojnë në mënyrë formale. Sipas Ligjit të prokurimit publik, autoriteti kontraktues do t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ofertën me çmimin më të ulët dhe ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit.

Merimanga e korrupsionit në Kosovë është mjaft e ngatërruar, sepse njerëzit nuk kanë edhe ku të ankohen, dhe sidomos është për të ardhur keq që në këtë rrjet të ndytë merimange janë futur edhe segmente të caktuara të sistemit të drejtësisë. Kjo e fundit në vend se t'i ndjekë zyrtarët në institucione, të cilët bllokojnë punët në disa fusha të biznesit, duke ua bërë me dije pronarëve që duhet dhënë diçka (para) për ta kryer atë punë që ke pasur ta kryesh në atë institucion, fatkeqësisht është bërë palë me këta zyrtarë të korruptuar, duke u nxjerrë lloj-lloj pengesash pronarëve të kompanive.

Edhe në perceptimin publik korrupsioni po tregon ngritje të frikshme. Në një studim të publikuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë më 9 dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, vihet në pah se rreth 42 për qind e të anketuarve besojnë se, krahasuar me pesë vjet më parë, korrupsioni në Kosovë është rritur, ndërkohë që përafërsisht 40 për qind e të anketuarve raportojnë se kanë hasur në korrupsion, që është një rritje prej 20-përqindësh krahasuar me studimin e vitit 2019.

Ndërsa më shumë se 45 për qind prej tyre i kanë renditur komunat si institucionet parësore ku është hasur korrupsioni, ndjekur nga 35 për qind të cilët kanë vlerësuar Administratën Tatimore të Kosovës. Kjo e fundit, nga 80 monitorime, ka regjistruar 30 raste të shkeljeve në rastin e prokurimit publik. Këtë shifër e ka bërë publike drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, i cili për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se si agjenci në aspektin e parandalimit të korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, si fusha më e korruptuar në vend, në këtë vit kanë trajtuar rreth 80 monitorime. Nga këto monitorime kanë lëshuar 34 opinione për autoritetet kontraktuese me qëllim shmangien e shkeljeve kundërligjore. Ai bën të ditur se bizneset kryesisht nuk e raportojnë korrupsionin në agjenci dhe se këtë e bëjnë te mekanizmat e tjerë.

Pengesat e të bërit biznes, si pasojë e korrupsionit të segmenteve të caktuara shtetërore, kanë zënë vend edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. Sipas këtij raporti, i publikuar në tetor, është theksuar se korrupsioni në Kosovë është i përhapur dhe vazhdon të jetë një shqetësim serioz. Aty ishte theksuar se nuk ka vullnet të fortë politik për t'i adresuar në mënyrë efektive çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin si dhe një përgjigje të fuqishme të sistemit juridik ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.

Kosova edhe në raportet e Bankës Botërore të quajtur "Të bërit biznes" ishte kritikuar për nivelin e lartë të korrupsionit, dukuri kjo e cila pengon zhvillimin e biznesit. Ndërkaq, në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për Klimën e Investimeve ishte theksuar se potenciali i investimeve të huaja direkte dhe rritja ekonomike në Kosovë, përveç të tjerash, janë të kufizuara edhe nga korrupsioni.

## Pasojat nga pandemia

Krahas problemeve që evidentuam më lart, ekonomia e Kosovës tash së fundi u ballafaqua edhe me një sfidë e cila është e përmasave globale. Sipas parashikimeve të Bankës Qendrore të Kosovës, ekonomia e vendit këtë vit pritet të shënojë rënie rreth 7.2 për qind si rezultat i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, të cilat ndikuan negativisht në pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike në vend. Por, edhe në këtë segment nuk mund të themi se institucionet shtetërore arritën t'i zbusin në masë të duhur goditjet e krizës shëndetësore mbi ekonominë. Nga rreth 1 miliard euro humbje sa vlerësohet se shënuan bizneset në Kosovë gjatë pandemisë me Covid-19, Qeveria e Kosovës deri më tani i ndihmoi ata me vetëm rreth 150 milionë euro. Në pakon emergjente të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej rreth 180 milionë eurosh, bizneset gëzuan një mbështetje financiare mbi 60 milionë euro. Me këto mjete ishte paraparë mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 eurosh për 2 muaj, subvencioni i qirasë deri në 50 për qind të vlerës e të tjera.

Ndërkaq, nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike i Qeverisë së Kosovës, i cili kap vlerën e më shumë se 350 milionë eurove, u ndanë 60 milionë euro për biznese, në bazë të listës së numrit të punëtorëve. Por, krahasuar me ndihmën që ka dhënë shteti për bizneset, humbjet janë shumë herë më të mëdha. Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, Odës Ekonomike Amerikane, Aleancës Kosovare e Biznesit, Odës së Afarizimit dhe shumë organizata të tjera ekonomike kërkuan ndihmë nga qeveria për bizneset, por ndihma që shteti ndau u vlerësua se nuk ishte e mjaftueshme.

Vetëm sipas të dhënave të fundit të Administratës Tatimore të Kosovës, bizneset në Kosovë kanë pasur afër 1 miliard euro më pak qarkullim gjatë periudhës së pandemisë krahasuar me vitin e kaluar.

Të hyrat e aktiviteteve ekonomike që u prekën më së shumti nga pandemia Covid-19, sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP, janë industria e ndërtimit, tregtia, transporti, akomodimi dhe gastronomia. Zhvillimet e pafavorshme në ekonomi janë reflektuar edhe në të hyrat buxhetore ku, sipas Ministrisë së Financave në Qeverinë e Kosovës, deri në fundin e vitit 2020 do të ketë rreth 300 milionë euro më pak të hyra për buxhetin e Kosovës.

Ndërkohë, gjatë periudhës shkurt - tetor, sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë, janë mbyllur 761 biznese të cilat kanë pasur të punësuar 1,316 punëtorë. Numri më i madh i bizneseve zyrtarisht të mbyllura kanë punuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, pasuar nga industria përpunuese, hoteleria dhe akomodimi. Në listën e bizneseve të mbyllura figurojnë edhe biznese në fushën e ndërtimit, informimit dhe komunikimit dhe sektorë të tjerë.

Goditja e rëndë ekonomike është reflektuar edhe në rritjen e papunësisë, pasi që masat për parandalimin e koronavirusit ndikuan që shumë biznese ta reduktojnë numrin e të punësuarve. Numri i saktë i personave që kanë humbur vendin e punës nuk dihet, por Oda e Ekonomike e Kosovës dhe ajo e Afarizmit kanë thënë se kemi të bëjmë me rreth 30 mijë të punësuar që gjatë pandemisë mund të kenë humbur vendin e punës.

Numri i qytetarëve të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit shënoi rritje në këtë periudhë. Sipas të dhënave të APK-së, numri total i të regjistruarve si të papunë deri në korrik është mbi 180 mijë. Problemet e grumbulluara në fushën ekonomike nuk mund të tejkalohen brenda natës. Ato kërkojnë qasje serioze dhe një përkushtim më të gjithanshëm jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe të mbarë shoqërisë, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë. Kjo e fundit duhet të jetë filtri më i besueshëm ku do të ndahej llumi që vjen prej ryshfetxhinjve të lidhur me pushtetin dhe afarizmit të ndershëm, i cili bën të pamundurën që me punë dhe sakrifica të mëdha të ndikojë në mëkëmbjen ekonomike e sociale të Kosovës.

Prishtinë, 13 dhjetor 2020

# Inaugurohet shtëpia e të moshuarve 'Jetimat e Ballkanit' në Suharekë

Shtëpia e të moshuarve "Jetimat e Ballkanit", e cila gjendet në fshatin Gjinoc të Suharekës, ka 13 mijë metra katrorë. Në këtë shtëpi janë 80 dhoma gjumi, gjashtë prej dhomave janë familjare. Po në katin e parë gjendet reparti mjekësor i cili do të jetë në shërbim 24 orë me mjekë të posaçëm për secilën fushë




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

SUHAREKË, 13 DHJETOR - Në fshatin Gjinoc të Suharekës është bërë inaugurimi i shtëpisë për të moshuarit "Jetimat e Ballkanit". Me këtë rast drejtuesi i shoqatës humanitare Halil Kastrati ka bërë dorëzimin e çelësave edhe për dy banorët e parë të kësaj shtëpie. Kastrati ka treguar se ideja për ndërtimin e kësaj shtëpie i erdhi kur e gjeti të vdekur një të moshuar për të cilin ishin duke u përkujdesur. "Sot jam me plot emocione. Nëse gaboj në fjalimin tim, mos ma zini për të madhe. Ky ka qenë projekti i jetës time. E falënderoj Zotin dhe juve për realizimin. Gjatë kësaj dekade të veprimtarisë sonë bamirëse si shoqatë dhe si person jam përballur me situata të ndryshme qoftë ekonomike, shëndetësore dhe sociale të qytetarëve anekënd Kosovës. Prekëse, rrëqethëse dhe të pakapërdishme janë rrëfimet e të moshuarve tanë që nuk kanë shijuar mundësinë të jenë prindër. Po i ndaj dy momente që ishin vendimtare për këtë projekt. Ne përkujdesemi për të moshuar pa përkujdesje dhe çdo muaj i furnizojmë me gjëra ushqimore. Njërin nga pleqtë që e vizituam kishte ndërruar jetë pa e parë askush dhe me sy hapur. E një tjetër më tha 'ti ke ledhatuar shumë jetimë dhe më lejo të t'i puth duart'. E falënderoj Zotin dhe të gjithë donatorët që ma mundësuan që unë të ledhatoj kokën e të moshuarve", ka deklaruar Kastrati.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe për Ministrinë e Shëndetësisë është justifikim moral promovimi i objekteve të tilla. Ai ka falënderuar Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" në krye me humanistin e madh Halil Kastrati, i cili bashkë me tre mijë qytetarë të tjerë kanë jetësuar këtë mision fisnik, ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve "Jetimat e Ballkanit". "Si institucione e kemi për obligim përkrahjen institucionale. Interesimi ynë ka vazhduar me mbështetjen shëndetësore. Do t'i marrim këto obligime dhe përkrahjen ta vazhdojmë që ata që qëndrojnë në këtë shtëpi të kenë përkujdesjen shëndetësore", ka deklaruar Zemaj.

Edhe ushtruesi i detyrës së kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, i cili mori pjesë në hapjen e shtëpisë së të moshuarve në Suharekë, ka thënë se Halil Kastrati me të gjitha veprat e tij, veçanërisht me këtë projekt të fundit, i ka dhënë shembull të gjithëve, edhe politikës.

Shtëpia e të moshuarve "Jetimat e Ballkanit" ka 13 mijë metra katrorë, me një sallë të ushqimit që do të ofrojë tre shujta në ditë, ushqimet për banorë do të gatuhen sipas gjendjes shëndetësore, por edhe dietave të përcaktuara nga stafi mjekësor, kuzhina ka kapacitet për të ushqyer 250 persona.

Në shtëpinë e të moshuarve "Jetimat e Ballkanit" janë 80 dhoma gjumi, gjashtë prej dhomave janë familjare. Po ashtu, në katin e parë gjendet reparti mjekësor i cili do të jetë në shërbim 24 orë me mjekë të posaçëm për secilën fushë.

# Policia kap mbi 50 kilogramë drogë në Prishtinë

EPOKA E RE Qendresa RAMA



PRISHTINË, 13 DHJETOR - Policia e Kosovës ka arrestuar mbrëmë tre persona në një parking të automjeteve në Prishtinë pasi të njëjtët dyshohen se kanë kryer veprën penale "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge". Policia ka njoftuar se gjatë këtij operacioni janë sekuestruar 51 kg drogë dhe 664.6 gramë substancë e dyshuar narkotike e cila dyshohet të jetë e llojit marijuanë, tri vetura, tetë telefona, 980 euro, 30 franga e një dollar. "Më datë 12.12.2020 rreth orës 18:50 në një parking të automjeteve në Prishtinë, Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve (DHTN) e PK-së, pas një hetimi disamujorë përmes aplikimit të masave të veçanta të hetimit, ka zhvilluar një operacion policor, me ç'rast ka ndaluar tre persona të dyshuar nën dyshimin se kanë kryer vepër penale e sanksionuar me ligj, respektivisht në bazë të nenit 267 të kodit penal të RKS-së 'blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge'. Tre personat e dyshuar në momentin e ndalimit kanë qenë duke shkëmbyer sasi të substancës narkotike dhe janë arrestuar nga njësitet antidrogë të Policisë së Kosovës", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar që të punojë me vendosmëri për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, në veçanti t'i luftojë dukuritë negative dhe aktivitetet kriminale që në një formë apo tjetër rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve tanë.

## Çështja e presidentit, Abrashi: Nëse nuk ka zgjidhje, në janar përgatitemi për zgjedhje

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Sekretari i përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së), Arban Abrashi, ka thënë se nëse partitë nuk merren vesh për zgjedhjen e presidentit, atëherë vendi në janar shkon në zgjedhje parlamentare. "Nëse nuk ka zgjidhje, në janar përgatitemi për zgjedhje", ka thënë Abrashi.

Ai ka thënë se zgjedhjet duhet të përfundojnë para marsit, kur vendi duhet ta ketë presidentin e ri. "LDK-ja ka një organizim të mirëfilltë nëpër degë dhe nëndegë nëpër komuna. Kryetari Mustafa e ka bërë të qartë se në qoftë se nuk ka zgjidhje shumë shpejt, në fillim të janarit ne duhet të përgatitemi ose po rrëshqasim drejt zgjedhjeve, sepse ato duhet të përfundojnë më herët në mënyrë që vendi të mos mbetet pa president, pasi ushtruesja e detyrës e ka një afat gjashtëmujor, kështu që do të shfaqeshin problemet se kush do t'i certifikojë zgjedhjet, por edhe problemet e tjera që mund të lindin nga jostabiliteti politik", ka thënë Abrashi në një intervistë për "Kosovapress".





# A po e kryejnë bankat detyrën e tyre gjatë pandemisë?

**Përfaqësuesit e bankave në Kosovë kanë vlerësuar se sistemi bankar në Kosovë ka luajtur një rol të rëndësishëm në aspektin e rimëkëmbjes ekonomike. Sipas tyre, gjatë kohës së pandemisë bankat komerciale kanë qenë në nivel të detyrës. Ndërsa njohësit e ekonomisë kanë kërkuar nga bankat dhe qeveria që të bashkëpunojnë në mes vete në mënyrë që të ndihmohen bizneset dhe qytetarët**

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Përfaqësues të bankave në Kosovë e kanë vlerësuar si të rëndësishëm rolin e sektorit bankar në rimëkëmbjen ekonomike gjatë dhe pas pandemisë Covid-19. Sipas tyre, bankat janë duke kryer "detyrën" e tyre dhe kanë kapacitete të mjaftueshme financiare dhe operacionale për t'i përmbushur nevojat për financim të korporatave dhe ekonomive familjare të Kosovës. Njohës të çështjeve ekonomike janë pajtuar se bankat janë biznese dhe nuk mund të heqin dorë nga fitimi, por kanë theksuar se në bashkëpunim me qeverinë mund të bëhet më shumë për ta kredituar ekonominë në këtë kohë të vështirë. Kjo mund të bëhet duke dhënë kredi me kushte më të favorshme për bizneset, përfshirë uljen e përqindjes së interesit (që do të subvencionohej nga qeveria), me "greis periudha" më të gjata, etj. Albert Lumezi, drejtor i bordit udhëheqës në Bankën "NLB", ka thënë për "Ekonomia Online" se roli i bankave në rimëkëmbjen ekonomike që nga fillimi i pandemisë ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm. "Sistemi bankar në Kosovë është mjaft i qëndrueshëm, stabil, mirë i kapitalizuar, si edhe likuid. Prandaj ne në asnjë moment nuk e kemi ndalur kreditimin; kemi vazhduar me një ritëm të njëjtë sikur edhe përpara pandemisë t'i përkrahim të gjitha degët e ekonomisë, sikurse dhe qytetarët e Kosovës. Besoj se ky është kontributi më i madh në rimëkëmbjen ekonomike, pra vazhdimi i kreditimit", ka thënë Lumezi, duke shtuar se nga fillimi i pandemisë kjo bankë ka dhënë kontributin e saj, duke shtyrë moratoriumin e kredive nga ana e huamarrësve pa llogaritur kamata ndëshkuese. "Trendi i normave të interesit në Kosovë është gjithnjë në zbritje. Nëse i analizojmë normat e interesit edhe në këtë periudhë, prej kuartalit në kuartal, shkojnë duke u zvogëluar në të gjithë sektorin bankar, gjithashtu edhe në 'NLB'", ka thënë ai.

### Balija: Nuk ka shumë vend për rritjen e kredive

Drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë se përhapja e pandemisë ka ndikuar edhe në sektorin bankar, duke sjell vështirësi operative dhe afariste. "Sa iu përket depozitave, kemi pasur një rritje prej rreth 145 milionë këtë vit, që ka çuar në 4 miliardë euro të depozituara në sektorin bankar. Nga këto 4 miliardë, mbi 70 për qind u takojnë qytetarëve, ekonomive familjare dhe rreth 30 për qind bizneseve. Këto depozita janë rritur falë një trendi pozitiv që kemi pasur ndër vite dhe gjatë pandemisë duket se një pjesë e mirë e qytetarëve kanë vazhduar të kenë të ardhura pa

## Abrashi: Vitin e ardhshëm nis ndërtimi i rrugës lidhëse nga Kodra e Trimave deri në Shkabaj

PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me kompaninë projektuese ka dalë në terren për t'i parë nga afër matjet gjeodezike të rrugës nga Kodra e Trimave deri në Shkabaj, përkatësisht rrugën lidhëse mes dy rrugëve nacionale, atë të Podujevës dhe Mitrovicës.
Ky është projekt i ri në kuadër të rrugëve të reja që do të ndërtohen në Komunën e Prishtinës. Ministri Abrashi tha se vitin e ardhshëm është paraparë ndërtimi i kësaj rruge, e cila do t'i lidhë dy rrugët nacionale, atë të Podujevës dhe Mitrovicës. "Kjo rrugë do të ketë ndikim të madh në shkarkimin e Prishtinës nga trafiku i ngarkuar, duke lidhur dy rrugë nacionale, atë të Podujevës dhe Mitrovicës. Po ashtu, fshatrat përreth do ta kenë më të lehtë qasjen në autoudhët e Kosovës përmes kësaj rruge si dhe hap perspektivën për krijimin e zonës ekonomike afër qendrës së panaireve", ka thënë Abrashi.
Kjo rrugë është në kuadër të projekteve të reja që Ministria e Infrastrukturës do t'i realizojë sipas buxhetit të vitit 2021. "Kemi paraparë që ndërtimin e kësaj rruge ta bëjmë me dy faza, e që do ta ketë edhe shtegun për çiklistë, duke plotësuar të gjitha standardet e një rruge model", është shprehur Abrashi.



Ministria e Infrastrukturës shpejt do ta nënshkruajë një memorandum bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës për ndërtimin e rrugës A dhe shumë projekte të tjera.

ndërprerë. Sektori publik ka pasur të ardhura të vazhdueshme, gjithashtu edhe për një pjesë të sektorit privat kanë vazhduar që t'i marrin pagat", është shprehur Balija për "EO". Ai ka thënë se gjatë këtyre muajve ka pasur ngecje në kreditim. "Sektori bankar ka kredituar mbi 1 miliard euro këtë vit, që do të thotë se ka pasur një kreditim të ngjashëm me vitin e kaluar. Në fakt, kemi pasur ngecje në kreditim gjatë muajve prill dhe maj, kur ka pasur rënie në kreditim në 65 për qind. Mirëpo me lehtësimin e masave është rikuperuar kreditimi dhe shohim se bankat kanë arritur të kreditojnë mbi 1 miliard euro për ekonominë e vendit", është shprehur Balija. I pyetur për mundësinë e futjes në ekonomi të këtyre 4 miliardëve të depozituara, drejtori i Shoqatës së Bankave ka theksuar se nuk ka edhe shumë vend për rritjen e kreditimit. "Nëse shohim depozitat të cilët kanë arritur në 4 miliardë euro shohim se rreth 3.2 miliardë euro janë në kredi dhe mbeten 800 milionë euro në likuiditet të sektorit bankar. Këto mjete do të mund të plasoheshin gradualisht varësisht prej dinamikës së rimëkëmbjes ekonomike. Por, për të marrë kredi bizneset dhe ekonomitë familjare duhet të ekzistojë një kapacitet absorbues i tyre. Nuk mund ta ngarkojmë më shumë me kredi", është shprehur ai.

Pavarësisht prej kritikave publike, Balija ka theksuar se sektori bankar është duke e luajtur rolin vetë për rimëkëmbjen e ekonomisë. "Duhet të jemi të vetëdijshëm se shoqëria jonë është duke kaluar nëpër një krizë shëndetësore, politike, ekonomike, dhe të gjitha këto bëjnë që shoqëria në Kosovë të ketë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Por, duhet të kuptojmë rolin e sektorit bankar siç është kreditimit i bizneseve dhe ruajtja e depozitave… Bankat kanë bërë tërë atë që është e mundur sa i përket ofrimit të lehtësirave për qytetarët", ka thënë Balija, duke shtruar se shtyrja e kredive ka qenë veprim i mirë i bankave.

Më tutje, Balija ka theksuar se sektori bankar duhet të ndihmohet me masa konkrete nga qeveria, përfshirë rritjen e kapitalit për fondin kreditor dhe subvencionimin e normave të interesit. Drejtori i Shoqatës së Bankave e ka përkrahur tërheqjen e 10-përqindëshit nga Trusti Pensional nga qytetarët pasi, sipas tij, kjo e rritë kërkesën agregate në këtë kohë të vështirë. "Kështu rritet konsumi në Kosovë dhe kjo i ndihmon dhe rritjes ekonomike të vendit", ka thënë ai.

Ndërsa drejtoresha ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit, Arieta Vula-Pozhegu, ka folur për vështirësitë e prodhuesve, sidomos në kohën e pandemisë për të siguruar likuiditet. Vula-Pozhegu ka theksuar se e kupton që bankat janë biznese dhe nuk heqin dorë nga fitimet. Por, ajo ka konsideruar se ka vend për uljen e interesave për kredimarrje, që aktualisht, sipas saj, janë mjaft të larta. "Gjithashtu, 'greis periudha' e kthimit është shumë e shkurtër. Nëse kjo periudhë do të ishte më e gjatë dhe nëse do të kishim ndryshime në interesin që kompanitë e paguajnë dhe në raste të ndryshme të ketë dhe shkallëzime të tjera, kjo do të ishte një ndihmesë për ne", është shprehur ajo.

Në anën tjetër, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se bankat duhet ta luajnë rolin e tyre në financimin e bizneseve, por ndihma kryesore në këtë kohë pandemie do të duhej të vinte nga qeveria. "Bankat janë aktorë që i financojnë bizneset me kushte të caktuara. Rritet rreziku, rritet edhe kostoja e financimit. Andaj ne këtu kërkojmë që ndihmën duhet ta japë shteti. Sistemi bankar operon si çdo biznes tjetër", ka thënë Rukiqi. Sipas tij, nevojitet koordinim dhe bashkëpunim nga të gjithë që të ruhen vendet e punës derisa të kalojë kriza e shkaktuar nga Covid-19. Për njohësin e çështjeve të ekonomisë, Arton Muhaxhiri, më të goditurat nga pandemia në Kosovë janë bizneset dhe kompanitë private dhe pikërisht këto duhet të ndihmohen më së shumti nga shteti. Muhaxhiri ka theksuar se janë 4 miliardë euro të kursimeve të qytetarëve nëpër bankat komerciale në Kosovës, të cilat, sipas tij, duhet të investohen në ekonomi. Ai ka thënë se bizneset duhet të ndihmohen nga bankat me kredi më afatgjata. "Qeveria një pjesë të interesit e paguan bashkë me biznesin. Janë dy forma, por që te ne nuk po aplikohet asnjëra dhe nuk ka asnjë iniciativë nga bankat në këtë dinamikë të rimëkëmbjes ekonomike. Në bankat tona janë 4 miliardë euro të kursimeve të qytetarëve të Kosovës dhe me një kreativitet të qeverisë duhet t'i nxjerrim jashtë bankave dhe të investojmë diku në Kosovë", ka thënë Muhaxhiri.

Ai ka kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti se nuk ka asnjë plan konkret për rimëkëmbjen ekonomike, megjithëse është ekonomist. Guvernatori i Bankës Qendrore (BQK), Fehmi Ahmeti, në një konferencë media para disa ditësh, kishte deklaruar se, përkundër vështirësive ekonomike aktuale, sistemi financiar vazhdon të mbetet i shëndoshë dhe stabil. Sipas parashikimeve të BQK-së, ekonomia e Kosovës këtë vit pritet të shënojë rënie prej rreth 7.2 për qind si pasojë e krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, që ndikoi negativisht në pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike në vend.

# Ismaili: Thesari i Kosovës është duke punuar për hapjen e të dhënave

**Prishtinë, 13 dhjetor** - Thesari i Kosovës është duke punuar në hapjen më të madhe të të dhënave. Drejtori i Thesarit të Kosovës, Ahmet Ismaili, ka thënë se hapja e të dhënave do ta lehtësonte punën e institucioneve dhe kjo është mjaft e rëndësishme edhe për publikun. "Informacion të bollshëm ka mjaft, pra regjistrat tanë kontabël janë të plotë dhe ka mjaftueshëm informata, mirëpo ajo informatë që është për publikun nuk duhet ta cenojë privatësinë e elementeve të tjera. Prandaj, kur do të bëhet kjo, ne do të sigurohemi që ta përfshijmë dhe shoqërinë civile, organizatat që janë mjaft aktive në këtë fushë, të sigurohemi që të publikojmë një informacion që është relevant dhe që i mundëson analizimit dhe mënyrës se si po shpenzohet buxheti, ku e rrit përgjegjësinë dhe llogaridhënien e atyre që e shpenzojnë atë", ka thënë Ismaili për "Telegrafin". Ai ka thënë se pandemia ka ndikuar negativisht në lidhje me riorganizimin e faqes zyrtare të Ministrisë së Financave. "Ne kemi pasur një plan për këtë vit, por për shkak të pandemisë Covid-19 ka ndryshuar që ta riorganizojmë uebfaqen e Ministrisë së Financave, ku do të krijohet një pjesë e veçantë për Thesarin e që do t'i mbledhë të gjitha informacionet e buxhetit në një format të lehtë dhe do t'i grumbullojë në një shtyllë që do të jetë lehtësisht e lexueshme për lexuesin. Hapja e mëtutjeshme duhet të kushtëzohet me zhvillimet që duhen bërë në softuerët tanë, po ashtu edhe në disa përshtatje ligjore. Ne kemi kërkesa përditë. Shumica e tyre grumbullohen në lidhje me përgjigjen që e japim ne dhe kjo na merr një kohë relativisht të madhe, sepse kërkesat janë të natyrës së ndryshme dhe kërkojnë punë manuale. Në dinamikën që jemi dhe aktivitetin e zakonshëm që e kemi, përballemi me afatin ligjor që duhet t'i përgjigjemi", është shprehur Ismaili.



# Azemi: Punëtorët e sektorit privat nga mospagesa e Trust-it brenda një viti humbin 50 milionë euro



**Prishtinë, 13 dhjetor** - Kryetari i Sindikatës së Pavarur i Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka bërë me dije se mospagesa e kontributeve në Fondin e Kursimeve Pensionale nga ana e kompanive private, punëtorët po humbin miliona euro brenda një viti. Për këtë çështje, Azemi ka lënë fajtorë pronarët e kompanive dhe shtetin për këto humbje në kurriz të punëtorëve të sektorit privat. "Punëtorët e sektorit privat brenda një viti humbin mbi 50 milionë euro Trust. Këto mjete shkojnë në xhepat e pronarëve të kompanive, bashkë me pushtetarët sepse edhe pronarët e kompanive nuk guxojnë që t'i lënë në këtë gjendje mbi 50 për qind të punëtorëve të sektorit privat pa kontrata pune. Por, megjithatë, bashkëpunimi i organeve gjegjëse me pronarët e kompanive dhe me shtetin ka bërë që punëtorët e sektorit privat të humbin mbi 50 milionë euro. Tani do të shpërfaqet mllefi i punëtorëve, sepse ata nuk e kanë ditur që kanë punuar me vite të tëra dhe në llogaritë e tyre nuk do të ketë asgjë. Tek tash do të dalin simptomat e reflektimit ndaj pronarëve të kompanive që e kanë keqpërdorur fuqinë punëtore", ka thënë Azemi. Ai ka thënë se të gjithë ata që bëjnë presion mbi punëtorët, në bazë të ligjit mbi grevat, pronarët e kompanive, ose kushdo qoftë, dënimi është nga 500 euro deri 5 mijë euro. Në këtë kontekst, ai ka thënë se gjatë kohës së grevës pronarët e kompanive nuk guxojnë t'i pengojnë ose kërcënojnë punëtorët sepse ata kërkojnë të drejtën e tyre ligjore.

# Qytetari nga Peja dorëzon në polici një shumë parash të gjetura

PEJË, 13 DHJETOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë ka njoftuar për një rast të dorëzimit të një portofoli (kulete) në Stacionin Policor në Pejë nga në qytetar nga Peja. Sipas njoftimit të policisë, në portofol kishte një shumë parash, kartela bankare, letërnjoftimin dhe disa dokumente të tjera. "Më datë 12.12.2020 rreth orës 13:50 një qytetar (cigareshitës) ka gjetur një kuletë në rrugën 'Eliot Engel', të cilën e ka sjellë në Stacionin Policor Pejë. Pas verifikimeve të nevojshme nga ana e policisë, është bërë identifikimi i pronares dhe e njëjta është ftuar në Stacionin Policor në Pejë, e cila ka pranuar kuletën, të hollat, kartelat bankare, letërnjoftimin dhe dokumentet e tjera. Me këtë rast Policia e Kosovës, falënderon qytetarin për gjestin e bërë dhe nivelin e lartë të përgjegjësisë qytetare. Urojmë që ky rast të jetë shembull i bashkëpunimit edhe më tutje i të gjithë qytetarëve me Policinë e Kosovës!", ka njoftuar Policia e Kosovës.



# Përfundon renovimi i shtëpisë 200-vjeçare në Prizren



PRIZREN, 13 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Beni Kizolli, përuruan shtëpinë 200-vjeçare të familjes Kajmakqiu, në lagjen "Kurilla", e cila u rinovua në kuadër të projektit "Fasadimi, konservimi dhe revitalizimi i shtëpive me vlerë kulturore-historike". Me këtë rast, kryetari Haskuka ka deklaruar se mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore, që i japin Prizrenit një pamje përrallore dhe e bëjnë për vete secilin person që e viziton, është një nga prioritetet kryesore të qeverisjes së tij. Po ashtu, kryetari Haskuka ka theksuar se Komuna e Prizrenit, duke e ngritur shumën nga 30 000 në 100 000 euro, ka trefishuar buxhetin e vitit të ardhshëm për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe personalisht ka propozuar që së bashku me Ministrinë e Kulturës të krijohet një fond i veçantë, në mënyrë që të rinovohen të gjitha shtëpitë e trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

# Kompania "Rimida" i dhuron Komunës së Podujevës 40 spërkatëse për dezinfektimin e shkollave

PODUJEVË, 13 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pranuar një donacion nga kompania "Rimida", prej 40 spërkatësesh për dezinfektimin e objekteve shkollore. Me rastin e pranimit të donacionit, kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, e falënderoi kompaninë "Rimida" për donacionin e dhuruar, duke e vlerësuar shumë të nevojshëm për dezinfektimin e shkollave në situatën aktuale me pandeminë Covid-19.

Përfaqësuesi i kompanisë "Rimida", Feston Fusha, me rastin e dorëzimit të donacionit, tha se 40 spërkatëset e dhuruara për dezinfektimin e ambienteve shkollore i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me ligjet e Kosovës për kualitet dhe afat të qëndrueshmërisë.



# Komuna e Klinës përkrah fermerët me mjete bujqësore

KLINË, 13 DHJETOR (ER) - Në kuadër të përkrahjes dhe subvencionimit në fushën e bujqësisë, Komuna e Klinës, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, i ka shpërndarë 13 motokultivatorë me frezë për fermerët. Në ndarjen e këtyre pajisjeve bujqësore ishte i pranishëm kryetari i komunës, Zenun Elezaj, nën shoqërimin e drejtorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Naser Morina.

Kryetari Elezaj me këtë rast është shprehur se si komunë kanë për qëllim që fermerëve t'u krijojnë kushte sa më të mira për punë pasi, sipas tij, kjo do të ndikojë edhe në avancimin tutje të sektorit të bujqësisë.

Ndërsa drejtori Morina ka theksuar se gjatë këtij viti kanë përkrahur në vazhdimësi bujqit dhe fermerët e Komunës së Klinës, duke filluar me serra, pemë, pastaj me makina mjelëse, spërkatës krahu dhe shumë të tjera. "Tani edhe pajisjet me motokultivatorë janë dëshmi se përkrahja në bujqësi nuk do të mungojë asnjëherë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe komuna në përgjithësi", ka thënë Morina.

Vlera totale e këtij subvencioni është 37 mijë e 700 euro.



# BEOGRADI, KRYEQYTET I TERRORIZMIT



Shkruan: Ragip SHALA

Terrorizmi është krim i organizuar që përbën llojin më të rëndë të veprës penale që manifestohet me akte irracionale të pamoralshme me dhunë tejet brutale. Zë fill me lindjen e shtetit, ka parakaluar nëpër tërë formacionet socio-politike, është bërë dukuri edhe në shoqërinë bashkëkohore. Formën më të sofistikuar e ka arritur në gjysmën e shekullit 20, sidomos pas përfundimit të luftës së ftoftë. Aktet e terrorizmit përbëjnë problemin më të ndërlikuar të shoqërisë moderne, burimin kryesor të pasigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë ka nxitur debate të ndryshme jo vetëm në nivel rajonal, evropian, por dhe global, madje edhe në KS të OKB-së. Varësisht prej rreshtimeve gjeopolitike të shteteve, përkufizimet për terrorizmin janë të ndryshme, prandaj harmonizimi i ligjeve kundër terrorizmit ndër shtete ka mbetur në gjysmë të rrugës. Sa i përket definimit të terrorizmit më të zëshëm janë edhe teoricienët serbë të cilët sipas "kutit" të interesave të tyre gjeopolitike terrorizmin e përkufizojnë si një akt të dhunës që ka një qëllim politik!? Ndër shumë teoricienë serbë dallohen prof. Vojin Dimitrijeviq, Zoran Jovanoviq dhe qendra e tyre për mbrojtje dhe siguri (ODB - Centar za Odbrane i Bezbednost) që ndodhet në Beograd. Terrorizmi, sipas tyre, është akt i kriminalitetit të organizuar me komponentë dhunën e frikshme për qëllime politike. Me doktrinën e terrorizmit, serbët nënkuptojnë mjetet, metodat e dhunës sistematike që provokojnë frikë dhe pasiguri te qytetarët, një luftë politike përmes terrorit individual!? Duke u bazuar në synimet nacionaliste, hegjemoniste dhe ekspansioniste serbe karshi fqinjëve, sidomos shqiptarëve, tërë terminologjia juridiko-politike për terrorizmin është përligjje e synimeve të Beogradit për Serbinë e madhe. "Qëllimi arsyeton mjetin" thënia e Makiovellit dhe definimi serb për terrorizmin si akte dhune për qëllime politike përbëjnë çelësin "kallauz" për ta shpalosur terrorizmin shtetëror serbë dhe krimet e gjenocidit serbë ndaj shqiptarëve, boshnjakëve dhe kroatëve, gjatë shpërbërjes së RSFJ-së. "Qëllimet politike" të ekspansionizmit serb janë "palosur" në projekte, elaborate shfarosëse ndaj shqiptarëve, që kanë rezultuar me spastrime etnike, vrasje, persekutime deri me krime të gjenocidit. Në kryeqytetin e Beogradit janë hartuar elaborate planëzuar dhe zbatuar nga krerët politikë, ushtarakë dhe fetarë me mjete vrasëse që nga thika, kallashi deri tek avionët luftarakë, për "qëllime politike". Beogradi, pos që ishte kryeqytet i dyfishtë jugosllavo-serb, ishte qendër diplomatike, seli dhe nikoqir i Samitëve të Lëvizjes së mosinkuadrimit që gravitonin shtetet arabe, afrikane dhe aziatike!? Pikërisht nga kryeqyteti Beograd kanë rrjedhur doktrina vrastare, që kanë rezultuar me mijëra viktima civilësh, shkatërrime dhe djegie në shumë shtete gjatë këtyre decenieve të fundit. Republika e Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës përbëjnë rast të veçantë nga aktet terroriste për "qëllime politike". Prandaj përkufizimet për terrorizmin duhet të përkojnë pikërisht nga shembuj të shumtë dhe tejet specifik të këtyre dy shteteve. "Qëllimi politik" i Beogradit, planizuar dhe zbatuar për një shekull ndaj shqiptarëve, shpalos formën dhe llojin krejtësisht specifik të terrorizmit. Specifikat e terrorizmit beogradas ndahen në tri lloje: Vetë terrorizmi, terrorizmi rajonal dhe terrorizmi ndërkombëtar.

A) Vetë terrorizmi: Serbia ka qenë arenë e vrasjeve politike gjatë tërë shekullit 19 dhe 20, sepse është në traditën e tyre të vrasin njëri-tjetrin për "qëllime politike", prandaj në Evropë njihen për epitetin "kraljubica", vrasës i mbretërve. Vetë terrorizmin serb e përbëjnë atentatet, djegiet kidnapimet, sidomos vrasjet në mes dinastive, organizatave kriminale dhe partive politike. Përgjakja në mes Karagjorgjeviqëve dhe Obranoviqëve ka rezultuar me vrasjen e katër "kralve": Petroviq Karagjorgje, Milan Obrenoviq, Aleksander Obrenoviq, Aleksandar Karagjorgjeviq. Viktimë të vetë terrorizmit serb janë edhe: anëtarët e kryesisë së RSFJ-së, Gjemajl Bijediq, Petar Stamboliq, si dhe kryeministri i Serbisë, Zoran Gjingjiq. Vetë terrorizmin serb më monstruoz e përbën vrasja e ushtarëve në kazermën e Paraqinit, vrasja e fëmijëve serbë gjatë dhe pas luftës në Pejë, Gaqkë të Lipjanit dhe Gorazhdec të Pejës. Pastaj vrasja e Oliver Ivanoviqit, plagosja e Momqillo Trajkoviqit, Vuk Drashkoviqit etj. Pjesë krejtësisht e veçantë e vet terrorizmit është djegia e kishave ortodokse të Kosovës me bekimin e Popave paganistë serbë më 2004.

B) Terrorizmi rajonal: Për "qëllime politike" serbët, pos që vrasin njëri-tjetrin, madje edhe fëmijët e tyre, ata kanë vrarë dhe po vrasin edhe fqinjët e tyre: shqiptarët, boshnjakët, kroatët. Terrorizmi serb në vazhdimësi, për një shekull, ka kryer qindra vepra kriminale të terrorizmit, në Shqipëri, Kosovë, Bosnjë, Kroaci, Gjermani, Suedi, Francë, Austri etj.

Krimin e organizuar në kryeqytetin Beograd e përbëjnë këto akte terroriste: atentatet, sulmet subversive, zjarrvëniet, helmimet, kidnapimet dhunimet, zhvarrosjet etj. Ndër aktet terroriste rajonale serbe prijnë atentatet të cilat për nga shtrirja gjeografike dhe koha përbëjnë krimin më të organizuar në historinë e terrorizmit jo vetëm rajonal, por dhe botërorë.

Distanca e kryerjes së atentateve arrin prej 300 km Beograd - Sarajevë, pastaj 500 km Beograd - Prishtinë deri në 2 350 km Beograd - Stokholm. Kurse për nga koha, që nga luftërat ballkanike (1912), gjatë dy luftërave botërore, gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë dhe vazhdon deri tani. Ndër atentatet e shumta veçohet atentati i Sarajevës ndaj Frand Ferdinantit (1914), që ishte shkasi i shpërthimit të Luftës Parë Botërore. Pastaj atentati në Shtugart ndaj vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, vrasjet e Anna Maria Lind - ministre e jashtme e Suedisë, Franz Josef Straus - ministër i Bavarisë në Gjermani etj.

Terrorizmi serb në formë subversive dhe zjarrvënie është ushtruar ndaj Shqipërisë, për vite të tëra që ka rezultuar me vrasje të qindra qytetarëve civilë, si dhe djegia e mijëra hektarëve pyje dhe ullinj. Helmimi me Sarin i të rinjve shqiptarë, kidnapimet e civilëve, si dhe dhunimet gjatë luftës në Kosovë dhe Bosnjë Hercegovinë dhe Kroaci përbëjnë aktet më të shëmtuara terroriste serbe. Aktin terrorist më irracional e përbëjnë zhvarrosjet e civilëve shqiptarë të vrarë gjatë luftës në Kosovë, bartja e kufomave dhe groposja në varreza masive në Serbi.

Një akt të tillë terrorizmi i pashembullt në botë përbën kulmin e krimit të organizuar, terrorizmit rajonal serb. Gjeneralët serbë kanë bartur mbi supe trupa të pajetë fëmijësh shqiptarë si trofe lufte disa i kanë varrosur në oborret e shtëpive të tyre, disa në kazerma ushtarake dhe varreza masive anë e mbanë Serbisë.

C) Terrorizmi ndërkombëtar: Kryeqyteti Beograd, pos që ka terrorizuar rajonet ballkanike dhe evropiane, ka terrorizuar edhe shtetet e Lindjes së Mesme, Magrebin dhe rajonet aziatike. Meqë në Beograd është themeluar Lëvizja e Mosinkuadrimit, në cilësinë e nikoqirit, atje kanë aterruar shumë protagonistë të terrorizmit botërorë: individë, organizata "revolucionare" dhe parti anarkiste të ekstremit të majtë. Veçohet kryeterroristi botëror Iliq Ramirez Shakalli "guerili revolucionar" i Titos, i cili për shumë kohë është strehuar në Beograd. Në Francë është dënuar me burgim të përjetshëm për sulmet terroriste më të përgjakshme, për vrasjen e 2 000 civilëve dhe sulmin terrorist në Lojërat Olimpike në Mynhen. Në kancelaritë e Titos, gjeneralit Kadijeviq, pastaj dhe Milloshevigit i kanë hyrë pa trokitur Idi Amini, Robert Mugabe, Sadam Hyseini, Mohamar Gadafi, Hafez al Asadi, të gjithë këta kriminelë të rangut botëror.

Në akademitë ushtarake të Beogradit kanë studiuar qindra kadetë arabë të prirë nga kolonel Gadafi, gjeneral Hyseini, të cilët janë indoktrinuar me doktrinën vrastare serbe. Organizatat terroriste: Hamas, Fronti Polisario, Armata e Kuqe, Brigadat e Kuqe, AL Kaida, ISIS, Hezbollah, Boka Harem, etj., janë furnizuar me armë të Zastavës së Kragujevcit dhe trajnuar nga gjeneralët serbë.

Tërë përgjakjet ndër-arabe, grushtshtet, lufta irako-iraniane, dhe lufta izraelo-arabe janë furnizuar me armë të Zastavës së Kragujevcit.

Terrorizmi rajonal dhe ndërkombëtar serb i bazuar në doktrinën nacionaliste dhe hegjemoniste vrastare ka shkaktuar ndërmarrjet ushtarake më të mëdha të paktit ushtarak NATO gjatë 50 vjetëve të fundit. Pikërisht shkaku i doktrinës vrastare serbe, pakti NATO, pos ndërhyrjes ushtarake në Bosnjë, Kosovë, është detyruar të ndërmarrë operacione luftarake në shumë rajone të tjera. Pas bombardimit të kryeqytetit Beograd 1999, në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar janë bombarduar edhe kryeqytetet simotra: Bagdadi, Tripoli, Damasku, Bejruti, Kabuli, Kajro etj. Këto kryeqytete u bombarduan nga Pakti NATO, të cilat për qendër ideologjike duke pasur Beogradin, nën influencën e doktrinës serbe, shefat e tyre kanë ndërmarrë veprime kriminale. Terrori shtetëror, ideuar, planifikuar, komanduar dhe zbatuar nga hierarkia shtetërore, mbështetur në doktrinën vrastare serbe përbën emblemën e Beogradit kryeqytet i terrorizmit me përmasa globale. Një emblemë e tillë ka rezultuar me krime të gjenocidit në Kosovë dhe Bosnjë në Libi, Irak dhe Siri, dhe përbën burimin kryesor të pasigurisë rajonale dhe globale. Kallashnikovët e Zastavës së Kragujevcit s'kanë të ndalur, vazhdojnë edhe më tej të vrasin civilë në metropolet evropiane dhe botërore. Beogradi ky kryeqytet i terrorizmit…





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Montimi Servisim Porosi
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Prishtina mposhti Ballkanin në derbi

Prishtina e fitoi derbin ndaj Ballkanit dhe ngushtoi epërsinë me këtë klub në shtatë pikë. Të dielën fitore ka realizuar Llapi ndaj Feronikelit dhe aktualisht është në pozitën e gjashtë në tabelë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 DHJETOR - FC Prishtina e ka fituar derbin e javës së 18-të në Superligën e Kosovës në futboll, pasi të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" e ka mposhtur Ballkanin me rezultat 2-1. "Penalltitë në minutat e fundit lënë gjithmonë hapësirë për trajnerët që pësojnë që të mendojnë se ndoshta nuk ishte penallti. Nga vendi ku qëndrova unë e pashë se kishte tërheqje ndaj Kryeziut në zonë. Në pjesën e parë Ballkani na bëri të vështirë punën, e në pjesën e dytë ndryshuam skemën, duke krijuar rastet tona. Jam i kënaqur me kolektivin pasi dhamë maksimumin dhe arritëm të fitojmë kundër Ballkanit që nuk është lehtë", ka thënë Zekirija Ramadani, trajner i Prishtinës.

Në minutën e katërt të ndeshjes u regjistrua rasti i parë për mysafirët, por sulmuesi Daku nuk arriti të ndalë topin ashtu siç duhet. Rastin më të mirë për shënim e pati në minutën e 24-t Blend Baftiu, por gjuajtjen e tij e ndali portieri Haxho. Në minutën e fundit të pjesës së parë, Otto John e kalon në epërsi skuadrën kryeqytetase. Mirëpo në minutën e shtatë shtesë të kësaj pjese, kapiteni Visar Berisha shërbehet mirë nga Thaqi dhe realizon për 1-1.

Pas një ore lojë, John e pati një mundësi të artë për t'i kaluar sërish vendasit në epërsi, por nuk arriti të shënojë. Më pas Korenica i mysafirëve godet fuqishëm, mirëpo gjuajtjen e tij e ndali portieri Haxho. Dy minuta para fundit të ndeshjes, Arbër Potoku e ndalon në zonën e rreptësisë Leotrim Kryeziun, kurse nga pika e bardhë i saktë u tregua Besnik Krasniqi që shënoi për rezultatin final 2-1. "Referimi nuk ka qenë i mirë, pasi ka pasur luftë në 16 metërsh, por ne jemi në Kosovë dhe i dimë të gjitha çfarë ndodh, kush bie, kush fiton e gjithçka… është koha e fundit për t'i ndalur këto gjëra, pasi edhe vjet humbëm titullin kështu. Prishtina luajti mirë, ndeshja ishte e luftuar. Ata patën



raste, patëm edhe ne, por kur gjyqtari vendos të bëhet protagonist, kështu është. Ne si trajnerë analizojmë njëri-tjetrin dhe përgatitim ndeshjen. Ne erdhëm për të fituar, por edhe një barazim do të na kishte konvenuar. Arritëm dy-tre herë ta rrezikojmë Prishtinën, por kështu përfunduan gjërat. Ne kemi pasur ecuri më të mirë e këtë e tregojnë edhe pikët. Po të ishte referimi korrekt Ballkani do të duhej të ishte në vend të parë me gjashtë pikë diferencë nëse gjyqtarët do të ishin korrektë me të gjitha ekipet njëjtë. Nuk ka qenë ndeshje për shtatë kartonë, pasi as nuk jemi prerë me bajoneta, as s'kemi luftuar me armë. Futboll kemi luajtur", ka thënë pas ndeshjes trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi.

**SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Prishtina - Ballkani | 2-1 |
| Llapi - Feronikeli | 3-2 |
| Besa - Gjilani | 1-2 |
| Të hënën takohen: | |
| 13:00 Drita - Arbëria | |
| 13:00 Trepça '89 - Drenica | |

**Tabela**

| | | Pikë |
|---|---|---|
| 1. Drita | 16 | 39 |
| 2. Ballkani | 17 | 38 |
| 3. Prishtina | 17 | 31 |
| 4. Gjilani | 17 | 26 |
| 5. Feronikeli | 18 | 23 |
| 6. Llapi | 18 | 20 |
| 7. Arbëria | 17 | 20 |
| 8. Trepça '89 | 17 | 20 |
| 9. Drenica | 17 | 18 |
| 10. Besa | 18 | 6 |

Pas kësaj ndeshje, Prishtina përforcohet edhe më shumë në pozitën e tretë me 31 pikë dhe tash ka vetëm shtatë pikë më pak se Ballkani në pozitën e dytë. Të dielën është zhvilluar edhe ndeshja tjetër mjaft interesante mes Llapit dhe Feronikelit. Fitues dolën llapjanët me rezultat 3-2. Yll Hoxha (autogol), Sava Gardasheviq dhe Arbnor Ramadani shënuan për skuadrën që drejtohet nga Tahir Batatina, kurse për skuadrën nga Drenasi realizues i dy golave ishte Simonovski. Llapi me tri pikët e marra të dielën është ngritur në pozitën e gjashtë me 20 pikë, kurse "Nikli" zë vendin e pestë me 23 pikë.

### Sot zhvillohen dy ndeshje

Sot (e hënë) zhvillohen edhe dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro në Superligë. Kampionia në fuqi dhe liderja aktuale e Superligës, Drita, e pret skuadrën e Arbërisë në Gjilan. Synimi i kësaj skuadre është fitorja në këtë ndeshje në mënyrë që ta shtojë diferencën me Ballkanin në katër pikë, por as klubi i Arbnor Morinës nuk do të dorëzohet dhe do të kërkojë befasi. Në ndeshjen tjetër përballen Trepça '89 dhe Drenica. Të dyja këto ndeshje zhvillohen nga ora 13:00.

# 'Profa' merr drejtimin e Gjilanit




GJILANI, 13 DHJETOR - Trajneri i njohur Bylbyl Sokoli është emëruar trajner i ri në skuadrën e Gjilanit, kurse prezantim i "Profës" është bërë të dielën. "Profa" debutimin do ta bëjë në ndeshjen e 1/16 së finales së Kupës së Kosovës ndaj KEK-ut. "Sport Club 'Gjilani' njofton se ka arritur marrëveshje me trajnerin Bylbyl Sokoli për ta marrë drejtimin e skuadrës. Debutimin për këtë edicion ai do ta bëjë në ndeshjen e 1/16 së finales së Kupës së Kosovës ndaj KEK-ut. Kjo do të jetë kontrata e dytë e punës e Sport Club 'Gjilanit' dhe trajnerit Sokoli, i cili kishte drejtuar skuadrën dhe katër edicion më parë. Profesor Sokolit i urojmë mirëseardhje dhe shumë sukses drejt realizimit të objektivave që ka vendosur klubi", thuhet në njoftimin e SC Gjilani.

# Peja dhe Prishtina pësojnë humbje

PRISHTINË, 13 DHJETOR - KB Vëllaznimi pasi mundi Sigal Prishtinën, ka shënuar fitore edhe ndaj Pejës me rezultat 85:62 (19:9, 23:17, 20:13, 23:23), në kuadër të javës së shtatë të Prince Caffe Superligës. Skuadra vendase e nisi ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 19:9. Kuqezinjtë vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, që e fituan 23:17, duke shkuar në pushim me epërsi 42:26. Vëllaznimi dëshmoi lojë më të mirë edhe në periudhën e tretë, 20:13, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 62:39. 10 minutat e fundit të kësaj përballe ishin vetëm formale, pasi vendasit ruajtën epërsinë e lartë. Kjo pjesë përfundoi 23:23, derisa Vëllaznimi triumfoi në fund 85:62. Te Vëllaznimi u dalluan Cendrik Council me 26 pikë e nëntë kërcime dhe Christopher Hortman me 22 pikë, nëntë kërcime e tetë asistime, derisa te Peja më të dalluarit ishin Drilon Hajrizi dhe Robert Cartëright me nga 17 pikë. Vëllaznimi ka tri fitore dhe katër humbje, kurse Peja gjashtë fitore dhe një humbje. Ndërsa Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës 83:74 (21:20, 25:12, 13:23, 24:19). Te Bashkimi u dalluan Musab Mala me 26 pikë, gjashtë kërcime dhe katër asistime dhe Julian Hamati me 15 pikë e tetë kërcime, kurse te Sigal Prishtina më të mirët në parket ishin Daniel Lekndreaj me 21 pikë e 11 kërcime, Fisnik Rugova me 17 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime dhe



Arian Qallaku me 19 pikë. Të dy skuadrat kanë nga dy fitore dhe pesë humbje.



## Besa fiton përballjen e parë ndaj Boracit

PEJË, 13 DHJETOR - Klubi i Hendbollit, Besa Famgas, ka mposhtur ekipin nga Bosnjë-Herzegovina, Borac. Besa të shtunën në palestrën "Karagaçi" në Pejë e mposhti Boracin e Banjallukës me rezultat 24:22. Pas pjesës së parë Besa kishte epërsi më të thellë, por kishte vështirësi në lojë në pjesën e dytë. Megjithatë, pejanët e mbajtën epërsinë dhe në fund fituan me dy gola dallim, 24:22. Ndeshja e kthimit luhet pas një jave në Banjallukë të Bosnjë-Hercegovinës. Vlen të thuhet që tetë vjet më parë skuadra nga Banjalluka kishte fituar ndaj Besës me diferencë të madhe prej 9 e 10 golash.

## Marku: Gjyqtarët ma vodhën fitoren

Londër, 13 dhjetor - Dueli mes Florian Markut dhe Stewart ka përfunduar në një barazim 76-76. Ky ka qenë vendimi i gjyqtarëve pas mbylljes së 8 raundeve, që e ka lënë të irrituar boksierin shqiptar. Marku është ndier i vjedhur nga gjykimi i këtij "match"-i, duke shpërthyer në deklaratat pas sfidës. Marku ka thënë se kjo ndeshje nuk duhet të mbaronte në barazim, pasi ai e kishte mundur në duel kundërshtarin duke pretenduar se kjo ishte një padrejtësi që iu bë boksierit shqiptar. "Të gjithë e patë se çfarë padrejtësie më bërën drejtpërdrejt në televizionin anglez, nuk e meritoja. Të gjithë janë habitur. Edhe komentatorët dhe vetë Stewart. Me të vërtetë kjo s'ka qenë nga performancat e mia më të mira, por e meritoja fitoren. E ula në tokë në raundin e dytë", ka thënë Marku.



# Salihu: Kundër Spanjës luajmë vetëm në 'Fadil Vokrri'

**Prishtinë, 13 dhjetor** - Në fillim të kësaj jave në Nyon të Zvicrës është hedhur shorti për fazën e kualifikimeve për në Kampionatin Botëror "Katar 2022". Përfaqësuesja e Kosovës bën pjesë në Grupin B së bashku me Spanjën, Suedinë, Greqinë, Gjeorgjinë dhe Suedinë. Menjëherë pas shortit ishte Kombëtarja e Spanjës ajo e cila përmes një reagimi nga Ministria e Punëve të Jashtme të saj ngriti dyshime rreth asaj nëse ndeshja do të zhvillohet në Prishtinë për shkak se Spanja ende nuk e ka njohur Kosovës si shtet. Në lidhje me këtë çështje, në një intervistë për "KosovaPress", ka folur sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, i cili theksoi se ndeshja ndaj Spanjës, kur Kosova është në rolin e vendasit, do të zhvillohet në Prishtinë, kurse sa i përket asaj që zhvillohet në Spanjë, iu takon atyre të vendosin. "Ndeshja kundër Spanjës do të zhvillohet në Prishtinë. Për fat të mirë për neve, nuk është vetëm Kosova rast unik. Kemi raste të shumta tani të shtete ndërmjet vete dhe nëse UEFA fillon tani të bëjë politikë selektive atëherë futbolli nuk do të zhvillohej, ndoshta si turnir duhet të bëhet", ka thënë Salihu. Madje Salihu e ka përjashtuar edhe Shqipërinë si një alternativë e një tereni neutral për zhvillimin e ndeshjes duke thënë se Kosova e ka stadiumin e vet dhe nuk kemi nevojë të luajë diku tjetër. "Nuk kemi nevojë të luajmë në terren neutral, e kemi stadiumin tonë", ka shtuar Salihu.




# Joshua mposhti Pulevin, paralajmëron duel me Furyn

**Londër, 13 dhjetor** - Anglezi me origjinë nigeriane Anthony Joshua është konfirmuar kampion bote në peshat super të rënda, pasi ka triumfuar të shtunën në mbrëmje në "Wembley" përballë bullgarit Kubrat Venkov Pulev. Nën praninë e një numri të kufizuar tifozësh për shkak të pandemisë Covid-19, Joshua pati nevojë për vetëm 9 raunde që ta fitojë përballjen me bullgarin dhe t'i hapë rrugë një sfide të bujshme me Tyson Fury, që pritet të mbahet më 2021-shin, raporton "SS". Me fitoren e arritur, 31-vjeçari ka arritur ta mbajë rripin e artë të kategorisë WBO, IBO, WBA dhe IBF, ndërsa tani pritet të përballet me patriotin e tij Tyson Fury për titullin WBC. Raundi i parë ishte njohës, me dy boksierët që më shumë ruheshin dhe studionin njëri-tjetrin. Në të dytin Pulev tentoi të befasonte me të majtën e tij të shpejtë dhe në një moment e kapi Joshua, por më parë kishte marrë disa goditje, mes tyre një nga poshtë në mjekër. Raundi i tretë ishte spektakolar, me AJ që lëshoi një breshëri grushtesh nga Kobrës bullgare. Ky u fundit përfundoi dy herë i shtrirë, por nuk u dorëzua. Ai u çua në këmbë dhe ia doli ta vazhdonte duelin. Jo vetëm kaq, por mori edhe raundin e katërt dhe të gjashtë, duke u munduar në çdo moment ta godasë Joshua. Ky i fundit sigurisht që e shfrytëzoi elementin gjatësi, duke e mbajtur larg 40-vjeçarin. Britaniku në raundin e shtatë i dha disa goditje të forta Pulevit, por ai vijoi të qëndronte në këmbë. Edhe raundi i tetë shkoi për Joshuan, ndërkohë që në të nëntin bullgari përfundoi dy herë i shtrirë në tapet dhe herën e dytë nuk ia doli më dot. I pranishëm në ndeshjen e djeshme ishte edhe ish-boksieri Floyd Mayweather, i cili nuk ka njohur asnjë humbje në 50 ndeshje të zhvilluara si profesionist, ndërsa Joshua karikoi tifozët me paralajmërimin për ndeshjen me Fury. "Jam gati për çdo lloj gjëje. Kush dëshiron të shohë Anthony Joshuan përballë Tyson Furyn në 2021-shin?", thirri anglezi 31-vjeçar duke marrë edhe brohoritmat e publikut të pranishëm.



## SHKURT

### Shkëndija shpallet kampione vjeshtore në Maqedoni

Të dielën u zhvilluan pesë përballje në Ligën e Parë Futbollistike të Maqedonisë. Skuadra e Shkëndijës me 3 pikë të arkëtuara në Strumicë ndaj Akademia Pandevit edhe zyrtarisht merr kurorën e kampionit vjeshtor. Skuadra tetovare mundi Akademia Pandevin me 1-0 falë realizimit të sigurt të Dashmir Elezit. Në derbin e Shkupit nuk kishte fitues, por u regjistruan katër gola. Vardari kaloi në epërsi me 2-0, ndërsa në vazhdim Makedonija GJorçe Petrovit arriti të shënojë dy gola dhe arkëtoi një pikë nga stadiumi "Todor Proeski". Në sfidat e tjera dominuan skuadrat vendase. Boresi me 2-0 mundi Sileksin, Pelisteri shënoi fitore minimale ndaj Bellasicës, ndërsa Struga Trim Lum mundi Rabotniçkin me 2-1.

### Broja infektohet me Covid

Sulmuesi i Kombëtares Shqiptare, Armando Broja, ka rezultuar i prekur nga koronavirusi në tamponin e kryer të shtunën dhe nuk ishte në dispozicion të Vitesses për sfidën ndaj Herenveenit. Lajmin e ka bërë me dije vetë klubi holandez. Infektimi me koronavirus mund të ketë mbyllur para kohe vitin për Brojën, duke qenë se ndeshjen e fundit për 2020-ën Vitesse do të luajë më 23 dhjetor, pra pas 10 ditësh dhe vështirë se sulmuesi do të rikuperohet para asaj date.

### Zidane: Atleticos nuk i lejuam asnjë shans, Kroos-Modriç janë të jashtëzakonshëm

Reali i Madridit, pas fitores kundër Barcelonës në Ligën e Kampionëve, mposhti në derbin e La Ligës ndaj Atletico Madridit (2-0). Trajneri Zinedine Zidane u shfaq mjaft i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve të tij dhe nuk i kurseu komplimentet për dyshen Kroos-Modriç, që ishin nga më të mirët në fushën e lojës. "Performanca e skuadrës ndaj Atleticos, ashtu si ndaj Borussias në Ligën e Kampionëve, ishte e një niveli mjaft të lartë dhe kjo më bën të lumtur. Kemi mposhtur një skuadër shumë të fortë, që nuk humbte prej 26 javësh në kampionat dhe ia dolëm duke ushtruar shumë presion dhe duke i lejuar vetëm një shans për gol. Ideja ishte t'i çonim në thellësi Modriçin dhe Kroosin, për të tentuar diagonalet dhe më duhet të them se ata të dy janë të jashtëzakonshëm. Megjithatë, mjaft mirë kanë bërë edhe Benzema, Vasquez, Carvajal, Varane e Ramos", ka deklaruar Zidane.

### Dortmundi shkarkon trajnerin Favre

Humbja turpëruese nga Stuttgarti dhe forma e dobët në ndeshjet e fundit i ka kushtuar me vendin e punës trajnerit Lucien Favre te Borussia Dortmundi. Sipas "kicker", zvicerani është shkarkuar të dielën nga klubi gjerman. Pasues i tij pritet të jetë fillimisht Edin Terziç.

### Maiconi rikthehet në Itali

Pas më shumë se katër vjetësh, mbrojtësi brazilian Maicon Douglas rikthehet në Itali, këtë herë për të luajtur me klubin modest të Sonas, që militon në Serinë D, apo kategorinë e katërt italiane. Rikthimi i 39-vjeçarit në Itali ishte paralajmëruar disa ditë më parë nga drejtori sportiv i Sona-s, Claudio Ferrarese. Mbrojtësi Brazilian mbërriti për herë të parë në Itali në verën e 2006-s, kur kishte 25 vjet mbi shpinë dhe iu bashkua skuadrës së Interit, fanellën e të cilit e mbajti veshur për 6 sezone. Në verën e 2012-s Maicon u transferua tek anglezët e Manchester Cityt, ku qëndroi vetëm një sezon dhe u rikthyer sërish në Serinë A, këtë herë për ta veshur fanellën e Romës, ku qëndroi për 3 sezone, sepse më 2016-n u rikthye në Brazil.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:442/1
Dt:11.12.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032,Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212,Ligjit për Arsimin dhe AftësiminProfesional04/L-138, Neni13dhe34,Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012(Neni4),Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018,Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPALLJE E KONKURSIT

**Në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2020/2021**

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita/Vend i ilirë | Vendi lirë/ Zëvendësim |
|---|---|---|---|---|
| SHML | Qendra e Kompetencës | Skenderaj | Një(1) mësimdhënës/e për lë nden Biznes dhe ndërmarrësi me normë të plot; | Zëvendësim |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon nëmënyrën e duhur ndaj tyre,duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:**

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

**Procedurat e konkurrimit:**

Afati i konkurrimit është 15ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.
Aplikacionit duhet t'i bashkëngjitenkopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen.
Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

TrafikuUrban

# K O N K U R S

**Pozita e punës:** Punëtor/e i/e autolarjes ( 6 pozita )

**Kohëzgjatja e kontratës:** 4 muaj

**Orari i punës:** I plotë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Bën pastrimin dhe larjen e autobusëve të TU brenda dhe jashtë, pastrimi bëhet sipas planit operativ të hartuar nga kryepunëtori.
- Pastron pjesët e brendshme të autobusëve nga mbeturinat dhe pluhuri sipas rendit kronologjik që vijnë ata në vendin e caktuar për pastrim.
- Pastrimi i autobusëve bëhet çdo ditë brenda dhe me spërkatje me ujë jashtë autobusit, ditëve të vikendit të shtuneve dhe të dielave bëhet pastrimi gjeneral i autobusëve,
- Pastrimi bëhet me kujdes që mos të dëmtohen kamerat dhe pajisjet tjera elektronike, për çdo prishje të pajisjeve elektronike të shkaktuar nga mos kujdesi gjatë larjes, mbani përgjegjësi – shpenzimet për eliminim të defektit i bartë vet punëtori-ja.
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të udhëheqësit, para të cilit është përgjegjës, përgjegjës për punë dhe disiplinë në punë
- Për punën e tij mbikëqyret direkt nga kryepunëtori.
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të administratës.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

1. Aplikacioni për punësim mund të merret në zyrat e Trafikut Urban apo përmes web-faqes së TU-së http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse posedon);
3. Kopja e letërnjoftimit;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

**Mënyra e Aplikimit:**

Kandidati/ja, duhet t`i dorëzoj këto dokumente në formë fizike në Zyren e Protokolit në Administratën e TU-në.

Konkursi është i hapur nga data 11.12.2020 dhe përfundon më datë 25.12.2020 në ora 16:00.

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 (0) 45 10 11 23

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 4076/20 të datës 11.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Adil Gurgusha shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Nehat Dana shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jeton Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Majlinda Kajdomqaj shpall të pavlefshme dëftesat e jl VI - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

▶ Hysen Rama shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.E.J. "Hoxhë Kadri Prishtinë" Prishtinë.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Pro Eng" Sh.p.k Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Koretishtë, Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.01.2021 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Gersheta" në Stanishor do të organizohet debat publik nga kompania "Pro Eng" Sh.p.k Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Koretishtë, Novobërdë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://us05web.zoom.us/j/4140781337?pwd=eTJySnVYMktsMGhBN0ZLZWprc1hwZz09

Meeting ID: 414 078 1337

Passcode: Z9ZDc2

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L